



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 186, datë 10.09.2021

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 224, SERIA T14P,  
PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË  
SHOQËRISË “SPAHIU GJANÇ” SH.P.K., ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S  
NR. 14, DATË 03.03.2014**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 42, pika 1, germa “ç” dhe nenit 107, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 5, germa “ç”, dhe nenit 6 dhe 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe pikës 3.8, pikës 4.5 dhe pikës 5.1, germa “ç”, të Kushteve të licencës së tregtimit të energjisë elektrike, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.09.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 118/1 prot., datë 01.09.2021, të përgatitur nga Grupi i punës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit të vitit 2020”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “SPAHIU GJANÇ” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 224, seria T14P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 14, datë 03.03.2014, për një afat 20-vjeçar.
- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 04.11.2020, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2020 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.
- Vendimi i Bordit të ERE sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë 19.11.2020. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1226/6 prot., datë 27.11.2020. Po ashtu,

shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 680/11 Prot., datë 19.05.2021.

- Me Urdhrin e Kryetarit nr. 50, datë 21.07.2021, “Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve për pagesat e rregullimit të vitit 2020 të pashlyera ndaj ERE-s”, u ngrit grupi i punës për fillimin e hetimit administrativ ndaj shoqërive të licencuara, që nuk kanë përmbushur detyrimin si më sipër, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çdo debitori dhe marrjen e masave të nevojshme administrative, për minimizimin e dëmit të shkaktuar si dhe vjeljen e debive të akumuluar.
- Shoqërisë “SPAHIU GJANÇ” sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 851/29 prot, datë 28.07.2021, duke i bërë me dije fillimin e hetimit administrativ dhe duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit të japë shpjegimet përkatëse në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s për pagesën e rregullimit të vitit 2020. Bashkë me këtë informacion, shoqërisë iu kërkuar që të përcjellë në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t’i shërbente hetimit administrativ të filluar më urdhrin e kryetarit.
- Në përfundim të afateve të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti “SPAHIU GJANÇ” sh.p.k., nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime, dhe as dokumentacion për sa kërkuar.
- Për sa më sipër rezulton se grupi i punës ka konstatuar nga ana e këtij të licencuari shkeljen si vijon:
  - *Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2020.*
- Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, në nenin 107, parashikon se, *për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën ç), të nenit 42, parashikon se, ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17, i këtij ligji.*
- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë mund të aplikohet vetëm për disa prej subjekteve debitore të vitit 2020, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shumica fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2020) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017.
- Neni 6, i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.04.2017, parashikon se:  
*Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijëni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konform nenit 107, të ligjit 43/2015, e cila përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.*
- Në pikën 4.5, të Kushteve të licencës së tregtimit të energjisë elektrike parashikohet se: *I Licencuari do ta informojë dhe sqarojë ERE-n për çdo shkelje të Kushteve të Licencës, jo më vonë se një javë pasi kjo shkelje i bëhet e njohur të licencuarit.*
- Në pikën 2, të Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016, “Mbi miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike”, është përcaktuar se *Efektet e kësaj licence për subjektet e licencuara përpara hyrjes së saj në fuqi, fillojnë me miratimin e këtij vendimi dhe për periudhën e mbetur të kohës së parashikuar në licencën aktuale, ndaj të gjitha subjektet e licencuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj licence, janë të detyruar të zbatojnë kushtet e saj deri në përfundimin e vlefshmërisë së licencës së tyre.*
- Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit, është fakt për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijëni në kohë nëpërmjet publikimeve në Fletoren Zyrtare të Vendimit për pagesat e rregullimit për vitin 2020, por edhe njoftimeve të përsëritura të dërguara për dijëni nga ERE, siç edhe cituar më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 224, seria T14P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SPAHIU GJANÇ” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 14, datë 03.03.2014.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.
3. Grupi i Punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**